

Autoriteti për Informimin mbi Dokumentet e Ish Sigurimit të Shtetit, bazuar në Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr.16, date 16.1.2019 “Per përcaktimin e numrit të punonjësve me kontratë të përkohshme për vitin 2018 në njësitë e qeverisjes qendrore”” si dhe Nr.483, datë 10.7.2019 ““Për disa ndryshime ne Vendimin Nr.16, date 16.1.2019 “Per përcaktimin e numrit të punonjësve me kontratë të përkohshme për vitin 2018 në njësitë e qeverisjes qendrore”” shpall kërkesën për punonjës me kontratë të përkohshme, me kohëzgjatje deri në 31 Dhjetor 2019.

I – Pozicionet

- Punonjës arkive **2 persona**

II – Dokumentacioni që duhet të paraqesin kandidatët:

- Kërkesën për aplikim;
- Curriculum Vitae të përditësuar, modeli Europass, me datën dhe firmën e personit;
- Fotokopje të pashaportës ose kartës së identitetit;
- Fotokopje të diplomës;
- Çdo dokumentacion tjetër që vërteton trajnimet, kualifikimet, arsimin shtesë, vlerësimet pozitive apo të tjera të përmendura në jetëshkrimin tuaj;
- Vërtetim të gjëndjes shëndetësore;
- Vetëdeklarim të gjëndjes gjyqësore.

Dokumentacioni i mësipërm duhet sjellë pranë zyrave të Autoritetit për Informimin mbi Dokumentet e Ish Sigurimit të Shtetit, në adresën; Rr.”Ibrahim Rugova”, Garda e Republikës, brenda datës **1.11.2019**.

III - Kërkesat që duhet të plotësojnë kandidatët:

- Të kenë përfunduar studimet e larta (bachelor), preferohet në degën histori/arkivistikë;
- Të kenë përvojë pune në sekretari/protokoll/arkiv, ose eksperiencë të ngjashme;
- Të kenë njohuri shume të mira mbi sistemin Windows dhe programet MS Office;
- Të jenë të aftë dhe të gatshëm për të punuar në grup, dhe të përballen me detyrat e punës nën presion;
- Përvoja e punës në administratën shtetërore përbën avantazh.

IV – Përzgjedhja e kandidatëve:

- Përzgjedhja fillestare e kandidatëve do të bëhet mbi bazën e dokumentave të paraqitura brenda datës **4.11.2019**;
- Të gjithë kandidatët do të njoftohen me email për rezultatet e përzgjedhjes brenda datës **4.11.2019**;
- Kandidatët e përzgjedhur nga faza e mësipërme do të nënshtrohen një interviste me gojë;
- Kandidatët fitues do të njoftohen me email, për të vazhduar me kompletimin e dokumentacionit dhe nënshkrimin e kontratës të punës (bazuar në Kodin e Punës) brenda datës **5.11.2019**.